



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 45/1 Prot

Tiranë, më 18/11/2021

VENDIM

Nr. 01, datë 18.11.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1611 Prot., datë 18.12.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet e-mail-it datë 27.11.2020, depozituar në adresën Etleva.Shore@infrastruktura.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me parkun e energjisë diellore në Karavasta, si më poshtë:

- *Kopje e plotë (përfshirë anekset dhe hartat e mundshme) të kontratës së nënshkruar midis Autoritetit Publik dhe kompanisë Voltalia, fituese e konkursit për Parkun Photovoltaik të Karavastës (140 MW).*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoritetit Publik, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1611/1 prot., datë 23.12.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, me e-mail-in datë 06.01.2021, koordinatoresha për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, ka informuar ankuesin dhe Zyrën e Komisionerit se: “*Në nenin 22 të kontratës së zhvillimit të projektit me shoqërinë Voltalia e nënshkruar më datë 31 korrik 2020, përcaktohet: “22.Konfidencialiteti dhe Publiciteti”, 22.1 Në zbatim të përjashtimeve të parashikuara në nenet 22.2 dhe 22.3, nga data e nënshkrimit deri në përfundimin apo zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje ose brenda një periudhe njëvjeçare pas përfundimit apo zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje, asnjë nga palët nuk nxjerr apo lejon që oficerët, punonjësit, agjentët apo kontraktorët e saj të zbulojnë përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje ose çdo informacion konfidencial tregtar lidhur me negociatat rreth kësaj marrëveshjeje të cilat mund t’i jenë bërë të njohura palës gjatë zhvillimit të negociatave të tilla apo lidhur me veprimet, kontratat, marrëveshjet tregtare apo financiare ose çështje të palës tjetër, pa marrë miratimin e palës tjetër.*”

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014, në të cilin parashikohet se: “*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve si dhe bazuar në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore me palët.*

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 12.01.2021, me prezencën e ankuesit dhe koordinatoresha për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër. Gjithashtu, koordinatoresha e Autoritetit Publik rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në e-mail-in e trajtuar më sipër, si dhe sqaroi ndër të tjera se: “*...Nga ana e Autoritetit Publik është ndjekur procedura e parashikuar, duke e vënë në dijeni palën kontraktuese, e cila është shprehur se shumë pjesë të kontratës konsiderohen me sensitivitet të lartë tregtar (për të cilat duhet ruajtur konfidencialiteti). Në këto kushte, nëse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim “MIE”) nuk respekton apo shkel nenet e kësaj kontrate (pa miratim apo marrëveshjen paraprake me palën kontraktuese), shoqëria Voltaia mund t’i drejtohet arbitrazhit ndërkombëtar*”.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit i kërkoi koordinatoresha së Autoritetit Publik sqarime në lidhje me procedurën dhe bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur Autoriteti Publik për nënshkrimin e kontratës, si dhe vlerësimin përfundimtar brenda datës 13.01.2021.

Koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, me e-mail-in datë 13.01.2021, argumentoi qëndrimin përfundimtar duke sqaruar se: *“Në vijim të seancës dëgjimore të zhvilluar me datë 12.01.2021 për ankesën e paraqitur nga z. [] , konfirmohet i njëjti qëndrim (zbatohen dispozitat/parashikimet e kontratës së nënshkruar mes palëve përsa i përket konfidencialitetit). Gjithashtu, në bazë të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.06.2018 “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, është zhvilluar procesi konkurrues për përzgjedhjen e ofertuesit për zhvillimin e projektit për ndërtimin e Impjantit Fotovoltaik, në zonën e Remas, Divjakë – Karavasta, Lushnje. Në përfundim të këtij procesi është shpallur fitues shoqëria Voltalia për të cilën është lidhur edhe kontrata përkatëse. Gjatë gjithë këtij procesi, MIE, është asistuar në hartimin e dokumenteve të procesit konkurrues dhe të Kontratës së Zhvillimit të Projektit nga Banka Europiane për Ndërtim dhe Zhvillim (BERZH), e cila ka vënë në dispozicion konsulentë ndërkombëtarë që kanë hartuar edhe kontratën përkatëse dhe kanë asistuar MIE në negociim. Si e tillë, kontrata reflekton praktikën më të mira të industrisë në këtë fushë”.*

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesës/ankesës ka të bëjë me një kontratë publike, për të cilën Autoriteti Publik, pretendon se nuk mund ta vendosë në dispozicion për shkak të parashikimeve të konfidencialitetit, të përcaktuar në nenin 22 të kontratës së zhvillimit të projektit, me shoqërinë Voltalia, e nënshkruar më datë 31 korrik 2020.

Komisioneri, vlerëson se dispozita e sipërcituar nuk është vendosur në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.06.2018 “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”.

Në asnjë nga dispozitat e parashikuara në legjislacionet e sipërcituara, mbi të cilat është zhvilluar procesi konkurrues për përzgjedhjen e ofertuesit për zhvillimin e projektit, nuk ka ndonjë parashikim lidhur me konfidencialitetin e kontratës dhe dokumentacionit të saj shoqëruar.

Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore Autoriteti Publik nuk provoi se është përpara kufizimeve të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Autoriteti Publik, sqaroi vetëm se, ka kërkuar nga shoqëria Voltaia miratimin për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar dhe kjo e fundit ka sqaruar se kontrata përmban të dhëna për të cilat duhet të ruhet konfidencialiteti.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik për mosdhënien e informacionit nuk rezulton i bazuar në ligj. Për më tepër, edhe nëse do të kishte aspekte konfidenciale, në frymën e pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të

drejtën e informimit”, sipas të cilit “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”, Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të kontratës të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tyre.

Kontrata e lidhur ndërmjet Autoritetit Publik dhe shoqërisë Voltaia është në thelb një kontratë administrative e cila i nënshtrohet ndër të tjera parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative, neni 119 e vijues. Një prej kushteve themelore të një kontrate administrative është respektimi i parimit të ligjshmërisë, duke garantuar mbrojtjen e parimeve themelore publike dhe moscënimin e të drejtave të qytetarëve. Për më tepër, vet qëllimi i lidhjes së një kontratë publike është realizimi i një objekti kontraktor në interes publik. Në një kontratë administrative Autoriteti Publik nuk gëzon të njëjtën liri dhe autonomi për përcaktimin e përmbajtjes së kontratës që gëzohet në rastin e një kontrate të së drejtës private.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posacme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet nenit 22 të kontratës me shoqërinë Voltaia, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 për të drejtën e informimit.

Për analogji, në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 25 përcaktohet kufizimi mbi Autoritetin Publik lidhur me publikimin e informacionit të marrë nga operatorët ekonomikë, të cilësuar si konfidencial, duke përfshirë në këtë kategori aspektet teknike, sekretet tregtare si dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

Siç mund të vërehet nga dispozita e mësipërme, konfidencialiteti lidhet me aspekte teknike, sekrete tregtare dhe të dhëna të tjera konfidenciale me të cilat Autoriteti Publik është njohur ose i janë vënë në dispozicion nga operatorët ekonomikë gjatë procesit konkurrues dhe jo me të gjithë kontratën publike në tërësinë e saj. Pra, në këtë përcaktim nuk përfshihet kontrata publike e cila edhe nga vetë emri është vetëshpjeguese për natyrën e saj.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar në parim përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe kufizimet e pasqyruara në kontratë nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet ta vendosi atë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Bazuar në sa më sipër, në lidhje me ankesën e z. ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankesa duhet pranuar.

Në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar parashikohet se, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1611 Prot., datë 18.12.2020 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 27.11.2020, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (Kopje e plotë (përfshirë anekset dhe hartat e mundshme) të kontratës së nënshkruar midis Autoritetit Publik dhe kompanisë Voltalia, fituese e konkursit për Parkun Photovoltaik të Karavastasë (140 MW), brenda datës 25.1.2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 18.1.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

